

VENDIM
Nr. 202, datë 16.3.2016

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS, PËR AUTORITETIN RRUGOR SHQIPTAR, TË NJË SIPËRFAQEJE TRUALLI FUNKSIONAL, BRENDA TERRITORIT TË PRONËS NR. 1137, ME EMËRTIM “HELIODROMI I REPARTIT USHTARAK NR. 3340”, ME VENDNDODHJE NË FARKË, TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, për Autoritetin Rrugor Shqiptar, të sipërfaqes truall funksional, prej 260 (dyqind e gjashtëdhjetë) m², brenda territorit të pronës nr. 1137, me emërtim “Heliodromi i Repartit Ushtarak nr. 3340”, me vendndodhje në Farkë, Tiranë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi, për ta përdorur për ndërtimin e segmentit rrugor “Pjesa verilindore, kthesa Sauku - Bregu i Lumit, Unaza e Jashtme e Tiranës”.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, nga truall funksional i pronës nr. 1137, me emërtim “Heliodromi i Repartit Ushtarak nr. 3340”, me vendndodhje në Farkë, Tiranë, të hiqet sipërfaqja truall funksional, prej 260 (dyqind e gjashtëdhjetë) m², dhe të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kanë kaluar në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

3. Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e përdorimit të sipërfaqes së pronës, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojnë atë ose t’ua japin në përdorim të tretëve.

4. Para fillimit të punimeve, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, nëpërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar, të ndërtojë rrethimin në kufijtë e rinj të pronës, të kryejë spostimin e rrjeteve inxhinierike që prek gjurma e rrugës, sipas parametrave dhe kushteve teknike, duke i kthyer në gjendjen e tyre të mëparshme, dhe për këtë, ndërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe Komandës së Forcës Ajrore, Tiranë, të hartohet aktmarrëveshje.

5. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Transportit dhe Infrastrukturës, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia e Inventarizimit dhe Trans-ferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryere-gjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Planvendosja e Pronës nr.1137, Heliidromi Farkë, Tiranë (Sipërfaqja që prek projekti rrugës varianti i fundit)

SISTEMI KOORDINATAVE SHETERORE

